



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Nr. 4535 Prot.

Fier më 14 /04/2025

PROJEKT-VENDIM

NR. 37 dt. 14 / 04 /2025

Për një shtesë për shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme nr.16/24-N6 , ZK.Nr.2443 , në kuadër të VKM-së nr.660, datë. 23/10/2024“ Për shpronësimin për interes publik,të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i qendrës së fshatit Libofshë, Njësia Administrative Libofshë, Bashkia Fier”.

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më dt. / /2025, i paraqitet për shqyrtim materiali nga ekzekutivi, në kuadër të procedurave ligjore të shpronësimit për interes publik, për një shtesë për shpronësimin për interes publik, të pasurisë së paluajtshme pronë private nr.16/24-N6 , ZK.Nr.2443 , në kuadër të VKM-së nr.660, datë. 23/10/2024“ Për shpronësimin për interes publik,të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i qendrës së fshatit Libofshë, Njësia Administrative Libofshë, Bashkia Fier”.

Në listën e pasurive të paluajtshme , pronë private të miratuara me vlerësimet paraprake për shpronësim për interes publik, me VKB Nr.106, datë 28/09/2023, pasuri të paluajtshme të shpronësuara me VKM-në nr.660, datë. 23/10/2024 “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i qendrës së fshatit Libofshë, Njësia Administrative Libofshë, Bashkia Fier”, pasuria e paluajtshme pronë private Nr.16/24-N6 , ZK.nr.2443 e llojit “ Njësi ” e cila posedohej dhe ishte në funksion me aktivitet e llojit “Njësi” nga shtetasja Dritë Thoma Sukulli , nuk ishte pasuri e pajisur me dokumentacion ligjor pronësie , certifikatë pronësie dhe për rrjedhojë nuk u miratua në listën emërore të pronarëve, me vlerësimet paraprake për shpronësim për interes publik (tabela e miratuar me VKB Nr. 106, datë 28/09/2023). Për këtë pasuri të paluajtshme pronë private, shtetasja Dritë Thoma Sukulli, pas disa praktikave administrative-ligjore me ASHK, Drejtorinë Vendore Fier, është pajisur me dokumentacionin ligjor për pasurinë e paluajtshme, kartelë e pasurisë së paluajtshme, fragment i hartës kadastrale, për pasurinë nr.16/24-N6 , ZK.Nr.2443 , e llojit “ Njësi ” me sipërfaqe 41 m2 , e vlefshme për shpronësim.

Nga ekzekutivi, bazuar në dokumentacionin ligjor dhe teknik të ASHK-së si dhe dokumentacionit të administruar nga Njësia Administrative Libofshë mbi matjet faktike dhe materialet fotografike të kësaj pasurie, është bërë vlerësimi paraprak për tu kërkuar shtesë për shpronësim për interes publik të kësaj pasuri të paluajtshme pronë private, të prekur nga gjurma e projektit “***Rikualifikimi i qendrës së fshatit Libofshë, Njësia Administrative Libofshë, Bashkia Fier***”.

Bazuar ne Ligjin Nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9 Pika 1.2, gërma "b", Ligjin Nr.8561,datë.22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, VKM.138, datë 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë për interes publik",i ndryshuar si dhe dokumentacionin tekniko-ligjor të pasurisë , ekzekutivi i Bashkisë :

Propozon:

1. Të miratojë një shtesë për shpronësimin për interes publik, të pasurisë së paluajtshme pronë private ,nr.16/24-N6 , ZK.Nr.2443 , pronar Drite Thoma Sukulli , në kuadër të projektit "Rikualifikimi i qendrës së fshatit Libofshë, Njësia Administrative Libofshë, Bashkia Fier", sipas tabelës bashkëlidhur këtij projekt-vendimi;
2. Vlera paraprake e shpronësimit për interes publik, do të përballohet nga Buxheti i Bashkisë Fier për vitin 2025;
3. Për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave ligjore të shpronësimit për interes publik në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Sektorin e Shpronësimeve , Tiranë ngarkohet ekzekutivi i Bashkisë Fier.

Konc.

Drejtoria Juridike

Drejt. E. Kapllanaj

Dr.e Menaxhimit të Pronave Publike

Drejt. A. Behari

Dr.e Financë -Buxhetit dhe Kontabilitetit

Drejt. P. Çina

KRYETAR

Armando Subashi

NË MUNGESË ME AUTORIZIM

Sekretar i Përgjithshëm

Martin Dodi

